FAKULTETI I FILOLOGJISË

PLANI STRATEGJIK 2020-2024

Nëntor 2019

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren

Rr. Shkronjave 1, 20000 Prizren

Republika e Kosovës

SHKURTESAT

UUHP	Universiteti ”Ukshin Hoti” Prizren
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
SHU	Shoqata e Universiteteve
MM	Memorandum Mirëkuptimi
BE	Bashkimi Evropian
ZBN	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ZSC	Zyra për Sigurimin e Cilësisë
QKA	Qendra e Karrierës dhe Alumnit
BKI	Bordi Këshilldhënës Industrial
TI	Teknologjia e Informacionit
USAID	Ndihma e SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar
MASHTI	Ministria e Arsimit Shkencës, Tek. dhe Inovacionit
KSHC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
PS	Parlamenti Studentor
NJA	Njësitë Akademike
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
KSHC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
MK	Manuali i Akreditimit
ASHBA	Ambasada e SHBAve në Prishtinë
ÖAD	Shërbimi Austriak për Shkëmbime Akademike

PËRMBAJTJA

1. **Fjala e Dekanit**
2. **Historik i shkurtër i Fakultetit të Filologjisë**
3. **Themelet e planit strategjik**
   - 3.1. Misioni
   - 3.2. Vizioni
   - 3.3. Vlerat
   - 3.4. Grupet e interesit
4. **Procesi i planifikimit strategjik**
   - 4.1. Analiza e pozicionimit
5. **Prioritetet strategjike**
   - 5.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
   - 5.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore;
   - 5.3. Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programin Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Angleze dhe Gjermane;
   - 5.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit;
   - 5.5. Zhvillimi i infrastrukturës;
   - 5.6. Kontributi i Fakultetit të Filologjisë në komunitet;
6. **Plani i veprimit**

FJALA E DEKANIT

Në cilësinë e Dekanit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren (UUHP), kam kënaqësinë e veçantë që në emër të stafit akademik, bashkëpunëtorëve dhe studentëve të tjerë si dhe në emrin tim personal t'ju prezantoj programet e studimit te Fakultetit të Filologjisë.

Fakulteti i Filologjisë i UUHP ofron studime të ciklit të parë Bachelor në tri programe: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.

Fakulteti i Filologjisë ofron mundësi për të gjithë studentët të përmbushin një pjesë të mësimit teorik dhe të praktikës profesionale si pjesë e obligueshme e programit studimor nëpër institucione shkollore sipas zgjedhjes së tyre.

Ne ju garantojmë se mbështesim pasionin dhe dëshirën e studentëve, drejt një karriere profesionale të suksesshme.

Prof. ass. dr. Ragip Gjoshi
U.d. Dekan i Fakultetit të Filologjisë

HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK

Ky plan strategjik është hartuar në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues të UUHP.

Plani Strategjik 2020-2024 është hartuar pas konsultimeve gjithëpërfshirëse të akterëve të brendshëm dhe të jashtëm të Fakultetit të Filologjisë dhe të UUHP. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të Fakultetit të Filologjisë në UUHP, do të mbështeten dhe udhëhiqen nga ky plan strategjik.

Anëtarët e grupit punues për hartimin e planit strategjik:

Prof. ass. dr. Flamur Shala, kryetar
Prof. ass. dr. Ragip Gjoshi, anëtar Prof.asoc.dr.
Prof. asoc. drIzer Maksuti, anëtare
Prof. ass. dr. Teuta Kafexholli, anëtare
Prof. ass. dr. Sermin Turtulla, anëtare
Prof. ass. dr. Ilir Krusha, anëtar Ass. Phd(c)
Dorinë Rakaj, anëtare
Edita Rexha, anëtare (përfaqësues i studentëve)
Hyrmet Berisha, anëtare (përfaqësues i Alumni)
Prof. Skënder Berisha, nga jashtë)

HISTORIKU I FAKULTETIT TË FILOLOGJISË

Fakulteti i Filologjisë u themelua në vitin 2014. Aktualisht, në Fakultetin e Filologjisë studiojnë 2135 studentë, të regjistruar që nga fillimi i punës, në vitin e parë akademik (2014/15).

Fakulteti i Filologjisë organizon programet për studime në nivelin bachelor. Brenda një periudhe afatmesme planifikon të hapë programin e studimeve master.

Programet e studimeve në nivelin bachelor:

- Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

Kërkimet shkencore dhe rezultatet e stafit akademik maten me publikimin e punimeve shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara në platformat e publikuara sipas Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.

Infrastruktura e Fakultetit të Filologjisë
Fakulteti i Filologjisë aktivitetin e tij akademik e zhvillon në objektin e ish Shkollës së Lartë Pedagogjike, më vonë Fakulteti i Edukimit dega në Prizren dhe aktualisht është objekti i përbashkët me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prizrenit. Fakulteti i Filologjisë ka 8 salla mësimi të pajisura me video-projektorë, tabela smart, tevelizorë, 5 zyra të personelit akademik, 3 zyra të administratës, një sallë të përbashkët të mbledhjeve dhe amfiteatrin e përbashkët me Fakultetin e Edukimit. Ka bibliotekën e specializuar të gjermanistikës-këndi austriak), dhe Bibliotekën Qëndrore të Fakultetit të Filologjisë.

1. THEMELET E PLANIT STRATEGJIK

1.1. Misioni

Misioni i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit "Ukshin Hoti" është përgatitja akademike dhe profesionale e studentëve për tregun e punës në Kosovë, në rajon dhe më gjerë, për t'i kontribuar ngritjes së mirëqenies, arsimimit dhe kërkimit shkencor të cilësisë së lartë, me mundësi të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat e lirisë, demokracisë dhe të diversitetit kultoror dhe gjuhësor.

1.2. Vizioni

Përgatitja e studentëve të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Gjuhës dhe Letërsisë Angleze dhe Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane për mësimdhënie dhe për studime të mëtejme shkencore dhe profesionale. Përvetësmi i strategjive të Procesit të Bolonjës, që kanë për qëllim aftësimin e studentëve brenda sistemit të studimit dhe aftësimit të tyre gjuhësor e komunikativ për tregun e punës dhe integrimin në hapësirën evropiane të Arsimit të Lartë, ku dija dhe kërkimi shkencor janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik.

1.3. Vlerat

Vlerat e Fakultetit të Filologjisë janë: Studimi i tri gjuhëve: shqipe, angleze dhe gjermane, i letërsisë shqipe, qytetërimit dhe letërsisë angloamerikane dhe gjermane; Studimi sipas standardeve evropiane të Arsmit të Lartë: programe me objektiva të arritshme, përfshirë rezultatet studimore të synuara; programe inkurajuese për studentët që të kenë rol aktiv në studime, bashkëpunimi me partnerë, shkëmbime akademike dhe punësim të të diplomuarve.

1.4. Palët e interesit

Palët e interesit të Fakultetit të Filologjisë:
Të brendshme: stafi akademik; stafi administrativ dhe teknik; menaxhmenti i njësisë akademike.
Të jashtme: studentët; alumni (studentët e diplomuar); shoqëria civile (OJQ); komuniteti shkollor; komuniteti shkencor; institucionet qeveritare lokale, nacionale e ndërkombëtare: (ÖAD, DAAD; FIBAA, DIMOS, etj.), Universiteti i Vjenës, Universiteti i Innsbruck-ut, Universiteti i Regensburg-ut, Universiteti i Graz-it; Universiteti Drake, Universiteti i Iowa-së, Agjencitë e ndryshme, Ambasada e SHBAve, Programet e Qeverisë së SHBAve, Ambasada e Gjermanisë dhe Austrisë, Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare "Lingua Albanica", Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, dhe universitetet e tjera partnere.

Statistika të përbmledhura

Paraqitja grafike (me diagrame) e statistikave kryesore lidhur me çështjet me interes të veçantë për Fakultetin e Filologjisë:

- Statistikat lidhur me numri i studentëve
  Të regjistruar në vitin e parë sipas viteve, që nga themelimi:

Dega	Gjinia	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19	Gjith.
Gjuhë shqipe	F.	86	112	91	95	78	462
	Gj.	122	146	131	109	95	**603**
Gjuhë angleze	F.	119	129	145	92	70	555
	Gj.	155	242	206	102	96	**801**
Gjuhë gjermane	F.	81	140	89	103	63	476
	Gj.	180	182	153	117	99	**731**
							2135

Dega		St.rregullt	v. akademik	2017/2018		
	Gjinia	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	
Gjuhë shqipe	F.	92	68	92	0	252
	Gj.	114	73	116	0	303
Gjuhë angleze	F.	77	67	115	50	209
	Gj.	119	82	140	59	400
Gjuhë gjermane	F.	70	49	40	20	179
	Gj.	118	69	50	30	267
Dega		St.rregullt	v. akademik	2018/2019		
	Gjinia	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	
Gjuhë	F.	79	67	100		236
Shqipe	Gj.	91	71	129		291
Gjuhë	F.	66	67	110	29	262
Angleze	Gj.	97	80	136	33	346
Gjuhë	F.	64	65	91	54	274
Gjermane	Gj.	99	100	220	72	491

Dega		St.rregullt	v. akademik	2019/2020		
	Gjinia	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	
Gjuhë Shqipe	F.	16	57	116	/	189
	Gj.	17	62	138	/	217
Gjuhë Angleze	F.	2	61	65	87	215
	Gj.	5	74	75	104	258
Gjuhë Gjermane	F.	2	45	42	/	89
	Gj.	2	61	52	/	115

- Numri i studentëve të diplomuar, sipas programeve studimore:
  - Gjuhë dhe Letërsi Shqipe ---- F-37 – M – 9 Gj-46
  - Gjuhë dhe Letërsi Angleze ---- F-41 – M – 8 Gj-49

- Gjuhë dhe Letërsi Gjermane ---- F-52 – M – 26 Gj-78

- Personeli i rregullt akademik, sipas titujve:
  - Prof. asoc. dr. - 2
  - Prof. ass. dr. - 8
  - Ass. – 1
- Stafi administrativ
  - 1 sekretare
  - 1 zyrtar administrativ

6

vjet
nga
themelimi

Fakulteti

3
Programe

3
Gjuhë

11
profesorë
të rregullt

1
asistente te rregullta

Fakulteti

3
Programe

3
Gjuhë

2. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Planifikimi strategjik i Fakultetit të Filologjisë

Fushat me prioritet strategjik:

Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie/mësimnxënie

Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programin Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë Letërsi Angleze, Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit

Zhvillimi i infrastrukturës

Kontributi dhe bashkëpunimi me komunitetin

PRIORITETET STRATEGJIKE

Plani Strategjik 2020-2024 i Fakultetit të Filologjisë ka identifikuar këto fusha me prioritet strategjik:



Përparësitë

- Studim i gjuhës dhe letërsisë shqipe, i gjuhës dhe letërsisë angleze dhe gjermane sipas standardeve bashkëkohore evropiane;
- Studime të avancuar të gjuhëve;
- Administratë efikase;
- Bibliotekë e specializuar dhe sallë leximi;
- Personel akademik i kualifikuar;
- Praktikë profesionale në bashkëpunim me organet arsimore të komunës;
- Dixhitalizim i menaxhimit te programeve.

Mangësitë

- Numër i vogël i mobiliteteve për studentë e mësimdhënës;
- Nevojë për lektorë dhe treg institucional i paaktualizuar;
- Kapacitete të ulëta për hartimin e projekteve
- Mungesë e të dhënave te IALve

Mundësitë

- Infrastrukturë e përshtatshme;
- Mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore;
- Mobilitet i personelit akademik dhe i studentëve;
- Ngritje e cilësisë së kërkimeve shkencore;
- Përfshirje në projekte ndërkombëtare (Erasmus+, Heras+, Cost Action, RCC, etj.)
- Përfshirje më e madhe në tregun e punës.

Sfidat

- Treg i punës i paprofilizuar;
- Shpërputhje ndërmjet numrit të stafit akademik dhe studentëve;
- Inkurajimi i punës kërkimore-shkencore;
- Migrimi i studentëve.

3. PRIORITETET STRATEGJIKE

Përmbledhje e shkurtër

Prioritetet strategjike për zhvillimin e Fakultetit të Filologjisë janë: mësimdhënia/mësimnxënia dhe Sigurimi i Cilësisë; zhvillimi i punës kërkimore-shkencore; kontributi i Fakultetit të Filologjisë në komunitetin në të cilin vepron (aktivitetet në shërbim të komunitetit); ndërkombëtarizimi dhe rrjetëzimi i Fakultetit të Filologjisë (marrëveshjet e bashkëpunimit, me prioritet ato fakultete të huaja prej të cilave është adaptuar 70% e programeve studimore; mobiliteti i stafit akademik dhe sudentëve etj.).

3.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Ngritja e kapaciteteve akademike në Fakultetin e Filologjisë;
- Objektivi strategjik 2: Ngritja e cilësisë së matjes së rezultateve dhe monitorimit;
- Objektivi strategjik 3: Ngritja e kapaciteteve administrative;
- Objektivi strategjik 4: Ngritja e cilësisë së monitorimit të vlerësimit.

3.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i cilësisë së punës kërkimore;
- Objektivi strategjik 2: Integrimi i hulumtimeve shkencore në procesin akademik;
- Objektivi strategjik 3: Përfshirja e studentëve në projekte hulumtuese shkencore;
- Objektivi strategjik 4: Botimi e revistës shkencore të Fakultetit të Filologjisë
- Organizimi i konferencave shkencore
- Botimi i monografive dhe teksteve universitare

3.3. Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programin Master në Gjuhë dhje Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze

- Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i programeve master shkencor dhe profesional;
- Objektivi strategjik 2: Akreditimi i programeve master shkencor dhe profesional;
- Objektivi strategjik 3: Zhvillimi i programeve me kapacitete profesionale.

3.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Objektivi strategjik 2: Shtimi i mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve;
- Objektivi strategjik 3: Ndërkombëtarizimi i programeve;
- Objektivi strategjik 4: Ngritja e kapaciteteve për bashkëpunim ndërkombëtar.

3.5. Zhvillimi i infrastrukturës

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Zhvillimi (përmirësimi) i infrastrukturës fizike;
- Objektivi strategjik 2: Zgjerimi i hapësirës mësimore;
- Objektivi strategjik 3: Ngritja e laboratorëve për kërkime eksperimentale;
- Objektivi strategjik 4: Pajisja me teknologji informative;
- Zbukurimi i ambienteve me fotografi të personaliteteve të shquara të gjuhësisë dhe letërsisë shqiptare dhe botërore.

3.6. Kontributi i Fakultetit të Filologjisë në komunitet

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Filologjisë ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i bashkëpunimit me komunitetitn shkollor të Prizrenit;
- Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i bashkëpunimit kulturor me Komunën e Prizrenit;
- Objektivi strategjik 3: Zhvillimi i kërkimeve të studentëve në komunitet;
- Objektivi strategjik 4: Shkëmbime ndërkulturore me komunitete.

Kampusi i UUHP

Fakulteti i Filologjisë

Të shënohen (ose pasqyrohen në formë grafike të diagramit) të dhënat kryesore mbi hapësirën mësimore, bibliotekat, laboratoret, kabinetet e informatikës dhe hapësirat e tjera përcjellëse brenda njësisë akademike



BIBLIOTEKA E UNIVERSITETIT

FJALA PËRMBYLLËSE

Fakulteti i Filologjisë do të vazhdojë të zhvillojë dhe avancojë kapacitetet akademike, profesionale dhe shkencore që të diplomuarit tanë të jenë të gatshëm për tregun e punës në Republikën e Kosovës, në rajon dhe më gjerë. Studimet e tri gjuhëve: shqipe, angleze dhe gjermane, e letërsisë shqipe, angloamerikane dhe gjermane, me objektiva të arritshme, përfshirë rezultatet studimore të synuara, me programe atraktive për studentë, që të kenë rol aktiv në procesin studimor; bashkëpunimi me partnerë për shkëmbime akademike, shënojnë disa nga vlerat e Fakultetit të Filologjisë. I dmosdoshëm do të jetë bashkëpunimi mes palëve të interesit siç janë: menaxhmenti i njësisë akademike, personeli akademik, personeli administrativ dhe teknik, në njërën anë dhe i studentëve, alumni (studentët e diplomuar), shoqërisë civile (OJQ), komunitetit shkollor, komunitetit shkencor, institucioneve qeveritare e lokale, nacionale e ndërkombëtare dhe agjencive të ndryshme, në anën tjetër, për të arritur sukseset e dëshirua.

Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies është ndër faktorët kryesorë të zhvillimit të Fakultetit të Filologjisë. Ngritja e kapaciteteve akademike dhe administrative, ngritja e cilësisë së matjes së rezultateve si dhe ngritja e cilësisë së monitorimit të vlerësimit, do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndër objektivat strategjikë do të jenë edhe organizimi i programeve të trajnimit për zhvillimin e personelit (didaktikë, hartim i projekteve shkencore, metodologji e punës shkencore); organizimi i grupeve-degëve për vlerësimin e cilësisë; bashkëpunimi me organizma trajnues profesionalë; bashkëpunimi profesional i personelit akademik brenda njësisë akademike.

Zhvillimi dhe ngritja e cilësisë së punës kërkimore-shkencore do të bëhet edhe me integrimin e hulumtimeve shkencore në procesin akademik dhe me botime në revistën shkencore, me pjesëmarrje në konferenca shkencore të organizuara nga fakulteti, me botimin e monografive dhe teksteve universitare, me përfshirjen e personelit akademik në projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe të studentëve në projekte hulumtuese sipas programeve.

Një nga risitë e Planit Strategjik do të jetë Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programe Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Angleze dhe Gjermane. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit do të bëhet me bashkëpunim ndërkombëtar, duke shtuar mobilitetetin e personelit akademik dhe të studentëve. Do të vazhdojë krijimi i lidhjeve me universitete dhe personalitete shkencore, përmes shkëmbimeve akademike.

Zhvillimi i infrastrukturës, si pajisja me laboratorë dhe me teknologji informative do të ndikojë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Bashkëpunimi me komunitetin do të zhvillohet me projekte të përbashkëta arsimore dhe kulturore, sidomos me komunën e Prizrenit, përmes drejtorive përkatëse.

Prof. ass. dr. Flamur Shala,
udhëheqës i grupit të punës për hartimin e Planit Strategjik të Fakultetit të Filologjisë.

Fakulteti i Filologjisë

GJUHËSI DHE LETËRSI

SALLË MËSIMI

GJATË KONFERENCËS

NË ISTITUTIN E GJUHËSISË DHE LETËRSISË - TIRANË

FJALORTH

Procesi i Bolonjës (Bologna Process / Bologna-Prozess) është një seri e takimeve ndërministrore dhe marrëveshjeve midis vendeve evropiane të dizajnuara për të siguruar krahasueshmërinë e standardeve dhe cilësisë së kualifikimeve të arsimit të lartë. Përmes **Marrëveshjeve të Bolonjës**, procesi ka krijuar Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, në veçanti nën Konventën e Lisbonës. Ajo është emëruar sipas vendit ku ishte propozuar, Universiteti i Bolonjës, me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës nga ana e Ministrave të Arsimit të 29 shteteve të Evropës, në vitin 1999, duke krijuar një pjesë të integrimit evropian.

Procesi i Akreditimit (Accreditation process /Akkreditierungsprozess) është vlerësimi i cilësisë në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë. Përmes procesit të akreditimit përkrah zhvillimin e cilësisë në këto institucione. Që institucioni i arsimit të lartë të përmbushë kriteret e pranueshme të cilësisë.

Sistemi evropian për grumbullim dhe transfer të kredive (ECTS – European Credit Transfer and Accumulation System / ECTS – Europäisches System zur Übertragung und Akkumulierung von Leistungspunkten) është një standard për krahasimin e arritjeve në studime dhe përformancës së studentëve të arsimit të lartë në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane që bashkëpunojnë në këtë fushë. Për studimet, ECTS kreditë jepen pas përfundimit me sukses të studimit. Një vit akademik korespondon me 60 **ECTS-kredi** që janë ekuivalente me 1500–1800 orë studimi në të gjitha vendet pa pasur parasysh standardin ose llojin e kualifikimit dhe

përdoret për ta lehtësuar transferin dhe avancimin nëpër tërë Bashkimin Evropian.

Koriza Europiane e Kualifikimeve – KEK (European Qualifications Framework, EQF / Europäische Qualifikationsrahmen für lebenslanges Lernen EQR) Korniza e kualifikimeve i klasifikon kualifikimet sipas një seri kriteresh për nivele të specifikuara **të të mësuarit e të arriturve**. Ajo synon të integrojë dhe koordinojë kualifikimet, si edhe të përmirësojë transparencën, aksesueshmërinë dhe cilësinë e kualifikimeve në lidhje me tregun e punës, sistemin e arsimit dhe të formimit, si dhe shoqërinë civile. Kornizat e kualifikimeve mbështesin të mësuarit gjatë të gjithë jetës (pra, të gjitha aktivitetet e të mësuarit që zhvillohen gjatë jetës), me synimin e përmirësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave brenda një perspektive personale, civile, shoqërore dhe/ose të lidhur me punësimin. Ky përkufizim mbulon gamën e plotë të të mësuarit zyrtar, jozyrtar dhe informal.

Projekti Tuning – (Tuning project/ Tuning-Projekt)
Projekti Tuning prej vitit 2001 mbështetet në kuadër të programeve SOCRATES, ERASMUS nga Komisioni Europian. Është një projekt për harmonizimin e strukturave arsimore në Evropë i nisur nga universitetet, i cili mëton të ofrojë një qasje konkrete për zbatimin e Procesit të Bolonjës në nivel të institucioneve të arsimit të lartë dhe të fushave lëndore.

Zona Evropiane e Arsimit të Lartë - Europian Higher Education Area – **EHEA /** Europäischer Hochschulraum (EHR) filloi si një iniciativë e përbashkët e përvjetorit të "Procesit të Bolonjës", në Mars të vitit 2010, gjatë Konferencës Ministrore Budapest - Vjenë. Si objektiv kryesor i Procesit të Bolonjës që prej fillimit të saj në vitin 1999, EHEA ishte menduar të siguronte sisteme të krahasueshme, kompatibile dhe koherente të arsimit të lartë në Evropë. Mes viteve 1999 - 2010, të gjitha përpjekjet e anëtarëve të Procesit të Bolonjës ishin të përqëndruar në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, e cila u bë realitet me Deklaratën e Marsit të vitit 2010 në Budapest - Vjenë.

Mobiliteti (Mobility / Mobilität)
Sigurimi i cilësisë (Quality assurance / Qualitätssicherung)
Ngarkesa e punës - Workload / Arbeitsbelastung
ENQA – European Association for Quality Assurance in Higher Education.
EUA – European University Association.
ENIC Network/NARIC Network European Network of National Information Centres/Network of National Academic Recognition Information Centres.
European Research Area (ERA) / Europäischer Forschungsraum (EFR).

Burimet

Glossary on the Bologna Process English – German – Russian. Beiträge zur Hochschulpolitik 7/2006. Bonn 2006. https://www.hrk.de/fileadmin/redaktion/hrk/02-Dokumente/02-10-Publikationsdatenbank/Beitr-2006-07_Glossary_Bologna.pdf
Korniza Evropiane e Kualifikimeve - https://ec.europa.eu/ploteus/sites/eac-eqf/files/eqf_interactive_brochure_sq_0.pdf
KORNIZA E KUALIFIKIMEVE PËR MËSIMIN GJATË GJITHË JETËS https://akkks.rks-gov.net/uploads/korniza_evropiane_e_kualifikimeve.pdf
ECTS dhe Procesi i Bolonjës - https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/92994-ECTS.pdf
Harmonizimi i strukturave arsimore në Evropë (Tuning) https://akkks.rks-gov.net/uploads/korniza_evropiane_e_kualifikimeve.pdf

PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Objektivit strategjik	Aktivitetet	Masat	Bartësit	Afati kohor	Kostoja (Euro)
Prioriteti strategjik 1: Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie						
1.	Ngritja e kapaciteteve akademike në Fakultetin e Filologjisë	Përgatitja dhe shpallja e konkursit të rregullt për personel akademik;	Përzgjedhja e personelit sipas konkursit për personel akademik;	UUHP, FF, Senati	2020-2021 2022-2023	1,198.00 muaji
2.	Ngritja e kapaciteteve administrative	Përgatitja dhe shpallja e konkursit për zyrtarë administrativë;	Përzgjedhja e zyrtarëve administrativë sipas konkursit;	UUHP	2020-2021	500,00 nuaji
3.	Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe matjes së rezultateve	Organizimi i programeve të trajnimit të personelit (didaktikë, hartim i projekteve shkencore, metodologji e punës shkencore);	Bashkëpunimi me organizma profesionalë; stafi i brendshëm	FF, UUHP, OJQ	2020-2023	1,000,00
4.	Ngritja e cilësisë së monitorimit të vlerësimit	Organizimi dhe takime në grupe-degëve për vlerësimin e cilësisë.	Bashkëpunimi profesional i personelit akademik-shkëmbim përvojash.	Dega, FF	2020-2023	000,000
Prioriteti strategjik 2: Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore						
1.	Ngritja cilësisë së punës kërkimore;	Përfshirja e personelit në projekte kombëtare e ndërkombëtare;	Zbatimi i standardeve të cilësisë së punës kërkimore;	FF, UUHP	2020-2023	000,000
2.	Integrimi i hulumtimeve shkencore në procesin akademik;	Përfshirja e të dhënave më të reja shkencore në programet mësimore;	Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në projekte hulumtuese;	FF, UUHP	2020-2023	000,000

3.	Nxjerrja e revistës shkencore të Fakultetit të Filologjisë, projekt;	Përfshirja e artikujve me përzgjedhje nga redaksia;	Regjistrimi, zyrtarizimi dhe zgjedhja e redaksisë;	FF, UUHP	2020-2023	**1,000,00**
4.	Organizimi i katër konferencave shkencore dhe ngritja e cilësisë	Përfshirja e studiuesve, me përzgjedhje;	Organizimi i mirë dhe profesional;	FF, UUHP	2020-2023	10.000.0
5.	Botimi i monografive dhe teksteve universitare.	Vlerësimi profesional i monografive dhe teksteve univer.	Monitorimi i botimit sipas kritereve në fuqi.	FF, UUHP	2020-2023	2.000,00
Prioriteti strategjik 3: Zhvillimi i kapaciteteve akademike për programin Master në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Angleze dhe Gjermane						
1.	Zhvillimi i programit master shkencor;	Zhvillohen takime me personelin akademik dhe ekspertët e fushave	Hartimi dhe përshtatja e programit me objektiva;	Dega, FF, UUHP	2021-2023	1,200,00
2.	Akreditimi i programit master;	Aplikimi dhe hartimi i programit për master shkencor;	Hartimi i programit sipas kritereve për akreditim	Dega, FF, UUHP	2021-2023	000,000
3.	Zhvillimi i programit me kapacitete profesionale.	Shpallja e konkursit të rregullt dhe pranimi i personelit akademik – dy profesorë për program.	Monitorimi dhe përzgjedhja e personelit sipas konkursit	Dega, FF, UUHP	2021-2023	000,000
Prioriteti strategjik 4: Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit						
1.	Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar;	Krijimi i lidhjeve me universitete dhe personalitete shkencore Aplikimi në programet: **Erasmus +, Fulbright; US Emabssy University Support Grants, HERAS+, COST Action, RCC, etj.**	Sigurimi i përkrahjes për hartimin dhe menaxhimin e projekteve të përbashkëta;	Dega, FF, UUHP	2020-2023	000,000

2.	Shtimi i mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve;	Aplikimi në projekte për shkëmbime akademike dhe të studentëve në Erasmus+, shkëmbime të drejtpërdrejta dhe **Erasmus +;**	Sigurimi i fondeve për shkëmbime; Projekti Erasmus+ ka fonde	FF,UUHP	2021-2023	000,000
3.	Ndërkombëtarizimi i programeve;	Aplikimi në **Erasmus+** për programe të përbashkëta me universitete të rajonit dhe ato evropiane;	Hartimi i një programi në gjuhën shqipe, angleze dhe në gjuhën gjermane, ofertë bashkëpunimi;	Dega, FF	2021	000,000
4.	Ngritja e kapaciteteve për bashkëpunim ndërkombëtar.	Trajnimi i personelit akademik për hartimin e projekteve për mobilitet dhe projkete të tjera.	Përzgjedhja e personelit për trajnim.	FF, UUHP	2020-2023	5.000.00
Prioriteti strategjik 5: Zhvillimi i infrastrukturës						
1.	Zhvillimi (përmirësimi) i infrastrukturës fizike;	Hartimi i projektit për renovim:	Zbatimi i standardeve për renovim;	FF, UUHP	2020	5,000,00
2.	Zgjerimi i hapësirës mësimore;	Hartimi i projektit për zgjerim;	Zbatimi i standardeve për zgjerim, (zyra për personel);	FF, UUHP	2020	2,000,00
3.	Ngritja e laboratorëve për kërkime eksperimentale;	Hartimi i projektit për ngritjen e loabortatorëve;	Përcaktimi për laboratorë të fonetikës etj.;	FF, UUHP	2021	,000
4.	Pajisja me teknologji informative;.	Hartimi i projektit për pajisje me teknologji: PC, projektorë dhe instalimi;	Përcaktimi për teknologji të avancuar;	FF, UUHP	2021	5,000,00
5.	Dekorimi i ambienteve me fotografi piktura e thënie të personaliteteve të shquara të gjuhësisë dhe letërsisë shqiptare dhe botërore.	Hartimi i projektit për pajisje dhe vënien e fotove dhe pikturave në hapësirat e Fakultetit.	Përzgjedhja e personaliteteve të shquara.	Dega, FF	2020	2.000.00

Prioriteti strategjik 6: Kontributi dhe bashkëpunimi me komunitetin					
1. Zhvillimi i bashkëpunimit me Drejtorinë e Arsimit në Prizren, Malishevë, Suharekë, Sharr;	Organizimi dhe mbajtja e praktikës profesionale sipas programit;	Caktimi i Institucioneve për bashkëpunim për praktikë;	Dega, FF, UUHP	2021-2023	000,000
2. Zhvillimi i bashkëpunimit kulturor me Komunën e Prizrenit;	Organizimi i shfaqjeve dhe shkëmbimi kuluturor; **panairi**	Sigurimi i përkrahjes nga Komuna;	Dega, FF, UUHP	2021-2023	000,000
3. Zhvillimi i kërkimeve të studentëve në komunitet; forcimi i bashkëpunimit ndërmjet fakultetit dhe institucioneve arsimore.	Vizita dhe Ekspedita mujore për hulumtimin dhe gjetjen e trashëgimisë kulturore dhe leksikut;	Sigurimi i përkrahjes nga Fakulteti dhe UUHP , nga DKA;	Dega, FF, UUHP	2021-2023	1,000,00
4. Shkëmbime ndërkulturore me komunitete	Organizimi i ekskursioneve të përbashkëta me studentët dhe komunitetet (Manastir, Korçë, Krujë,)	Sigurimi i përkrahjes nga fakultetet përkatëse dhe UUHP.	Dega, Fakultetet, UUHP	2021-2023	2,000,00